



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 121 dt. 11.12.2014

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.12.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Përgatitja e projektit dhe dosjes së tenderit në lidhje me punimet e Restaurimit në qytetet e Trashëgimisë Historike, Vendodhja –Elbasan, Berat, Vlorë, Burrel, Krujë dhe Shkodër". (Faza e Dytë - projekt-zbatimi)“ me këto kushte për qytetet:
 - Elbasan:
 - Të mos realizohet rrethimi i propozuar i rrënojave të Bazilikës në projektin e zbatimit.
 - Të vendosen tabela informuese dhe edukuese përgjatë perimetrit të rrethimit ekzistues.
 - Berat:
 - Miratohet varianti sistemimit të terrenit me mobilim me stol rrethor në hyrjen e Belvederes, me veshje me gurë.
 - Kanalinat për ndriçuesit me braçeta të vendosen sipas tre varianteve (e fshehur, vertikal apo horizontal) sipas gjykimit rast pas rastit nga supervizori, gjatë zbatimit të punimeve.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO BURXHI

